



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KRYETARI

Nr. 61004-00141-00-2026 Regjistrimi

VENDIM I NDËRMJETËM

Për nisjen e procedurës për ndryshimin e pjesshëm të praktikës së njësuar të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të vitit 2011 mbi masat e sigurimit personal

KOLEGJEVE TË BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

Në Gjykatën e Lartë është regjistruar për shqyrtim çështja penale me nr. 61004-00141-00-2026, datë 16.02.2026, që i përket procedimit penal ndaj shtetasit Begtash Zeneli, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

Sipas akteve të dosjes, më datë 16.10.2025, gjatë kontrollit të ushtruar nga Policia e Lezhës në banesën dhe ambientet përreth në përdorim të shtetasit Begtash Zeneli, janë gjetur dhe sekuestruar rreth 7.350 kg lëndë e dyshuar narkotike e llojit cannabis sativa. Në vijim, ndaj tij është kryer arrestimi në flagrancë dhe prokuroria ka kërkuar vlefhtësimin si të ligjshëm të arrestit, si dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë ka vendosur vlefhtësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e kësaj mase, ndërsa Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, mbi ankimin e mbrojtjes, ka ndryshuar llojin e masës së sigurimit duke caktuar “arrest në shtëpi”.

Kundër këtij vendimi të gjykatës së apelit, më datë 12.12.2025 prokurori ka paraqitur rekurs. Personi nën hetim është njoftuar për rekursin nëpërmjet mbrojtësit të tij.

Në thelb, prokurori ngre tri shkaqe kryesore në rekurs. *Së pari*, pretendohet se Gjykata e Apelit ka zbatuar gabim nenet 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk ka kryer një analizë të mjaftueshme të rrethanave konkrete të faktit, të rrezikshmërisë së veprës penale dhe të personit nën hetim, duke arritur pa bazë të mjaftueshme në përfundimin se masa “arrest në shtëpi” ishte e përshtatshme. *Së dyti*, pretendohet se, në kushtet konkrete të çështjes, masa “arrest në burg” duhej konsideruar masa e vetme e përshtatshme, duke pasur parasysh natyrën e veprës, sasinë e lëndës narkotike, rrethanat e zbulimit dhe të kaluarën kriminale të të dyshuarit. *Së treti*, pretendohet

se papërshtatshmëria e masës “arrest në burg” mund të pranohet vetëm nëse i dyshuari ose mbrojtësi i tij paraqesin prova pozitive që përjashtojnë ose ulin gjendjen e rrezikut në një shkallë të tillë që të justifikojë zbatimin e një mase më të butë.

Këto tri shkaqe, të marra së bashku, tregojnë se argumentimi i rekursit mbështetet drejtpërdrejt në qëndrimin e mbajtur nga Kolegjet e Bashkuara në vendimin unifikues nr. 7, datë 14.10.2011, lidhur me standardin e arsyetimit gjyqësor për llojin e masës së sigurimit, raportin ndërmjet “arrestit në burg” dhe masave alternative, si dhe barrën e provës në vlerësimin e gjendjes së rrezikut.

Në këto kushte, çështja konkrete nuk paraqet interes vetëm për zgjidhjen e rastit individual, por ngre nevojën për të vlerësuar nëse praktika e konsoliduar nga vendimi unifikues nr. 7, datë 14.10.2011, duhet të vijojë të mbahet në të njëjtin kuptim apo kërkon rishqyrtim të pjesshëm, si dhe nëse, krahas këtij rishqyrtimi, paraqitet nevoja për njësim ose zhvillim të mëtejshëm të praktikës gjyqësore në zbatimin e neneve 228-230 të Kodit të Procedurës Penale.

I. Shkaku dhe nevoja e nisjes së procedurës për ndryshim

Vendimi unifikues nr. 7, datë 14.10.2011, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbi masat e sigurimit personal, ka pasur rol orientues në praktikën gjyqësore. Ai ka theksuar se vendimmarrja mbi masën e sigurimit duhet të mbështetet, në radhë të parë, në ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova dhe në arsyetimin e gjendjes së rrezikut, duke kërkuar që gjykata të mbështetet në elemente objektive dhe subjektive dhe jo në supozime të përgjithshme. Këto qëndrime përbëjnë një vlerë orientuese që ruajnë rëndësinë e tyre edhe sot.

Megjithatë, përvoja e zbatimit të këtij vendimi në praktikën gjyqësore ka vënë në diskutim nëse disa prej formulimeve të tij i përshtaten plotësisht zhvillimeve të mëvonshme të legjislacionit procedural penal, si dhe standardeve të zhvilluara nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në interpretim të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Përpara se të evidentohen disa prej ndryshimeve ligjore të ndërmarra në vitet 2017 dhe 2021, si dhe standardet e zhvilluara nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut pas dhënies së këtij vendimi, është e nevojshme t’u referohemi disa prej qëndrimeve të shprehura në vendimin unifikues nr. 7/2011. Konkretnisht:

1. Në këtë vendim unifikues është mbajtur qëndrimi se gjatë shqyrtimit të masave të sigurimit, gjykata mund të mos analizojë alternativat, por mjafton të pohojë përshtatshmërinë e masës që vendos. Në vendim thuhet: *“Si në rastin kur masa e sigurimit caktohet për herë të parë, ashtu edhe kur shqyrtohet zëvendësimi i masës ekzistuese, **gjykata nuk ka detyrim që të analizojë** përse llojet e tjera të masave të sigurimit nuk janë të përshtatshme, mjafton që të argumentojë se masa e caktuar prej saj në rastin konkret ndaj të gjykuarit është masa e përshtatshme.”*

Më tej, vendimi unifikues e rritetson të njëjtën qasje se *“...edhe në rastin kur vendos caktimin e masës së sigurimit arrest në burg, **gjykata nuk ka detyrim të analizojë në hollësi përse llojet e masave të tjera nuk janë të përshtatshme në çështjen në gjykim.** Bazuar në*

elementet objektive mbi natyrën dhe llojin e veprës penale, mjetet dhe mënyrën e kryerjes së saj, pasojat e shkaktuara, si dhe në elementet subjektive të lidhura me personalitetin e të gjykuarit dhe gjendjen e rrezikut, gjykata argumenton se masa e vetme e përshtatshme ndaj të gjykuarit në raport me llojin dhe shkallën e rrezikut është ajo e arrestit në burg.”

2. Në vendimin unifikues pranohet shprehimisht se ***“Në rastin e procedimeve penale për kryerjen e krimeve të rënda apo që kanë sjellë pasoja të rënda, për vetë natyrën e këtyre veprave penale, të mënyrës së kryerjes e të pasojës së ardhur, është i pranishëm elementi i shkallës së lartë apo të rëndësishme të rrezikshmërisë së autorit të tyre sipas nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale.”*** Në të njëjtën linjë, vetë vendimi unifikues ka pranuar edhe se “rreziku i largimit” mund të lidhet ***“edhe nga vetë natyra e akuzave në ngarkim të të gjykuarit, nga rëndësia e faktit, e sanksionit për veprën penale dhe lloji e shkalla e pasojave të ardhura prej saj”***.
3. Vendimi unifikues nr. 7/2011 vendos një standard për rastet e procedimeve penale që lidhen me krime të rënda, duke e lidhur “papërshtatshmërinë” e arrestit në burg me barrën e të provuarit nga i pandehuri. Në këtë vendim thuhet: ***“Masa e sigurimit arrest në burg e kërkuar nga prokurori ndaj të gjykuarit mund të çmohet nga gjykata si e papërshtatshme, vetëm nëse ai ose mbrojtësi i tij i paraqesin gjykatës prova pozitive që tregojnë se kjo gjendje rreziku nuk është e pranishme, apo që nuk është e pranishme në atë shkallë e rëndësi që të bëjë të zbatueshme masën e sigurimit arrest në burg.”***

Në këtë kuadër, rishqyrtim të posaçëm kërkojnë sidomos disa formulime të vendimit unifikues nr. 7/2011, ndër të cilat veçohen këto qëndrime:

Së pari, qëndrimi sipas të cilit, kur kërkohet ose vendoset masa e sigurimit “arrest në burg”, *“gjykata nuk ka detyrim që të analizojë përse llojet e tjera të masave të sigurimit nuk janë të përshtatshme, mjafton që të argumentojë se masa e caktuar prej saj në rastin konkret ndaj të gjykuarit është masa e përshtatshme”*.

Së dyti, qëndrimi sipas të cilit, në rastin e procedimeve penale për kryerjen e krimeve të rënda apo që kanë sjellë pasoja të rënda, *“për vetë natyrën e këtyre veprave penale, të mënyrës së kryerjes e të pasojës së ardhur, është i pranishëm elementi i shkallës së lartë apo të rëndësishme të rrezikshmërisë së autorit të tyre sipas nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale”*, si edhe formulimi sipas të cilit “rreziku i largimit” mund të lidhet *“edhe nga vetë natyra e akuzave në ngarkim të të gjykuarit, nga rëndësia e faktit, e sanksionit për veprën penale dhe lloji e shkalla e pasojave të ardhura prej saj”*.

Së treti, qëndrimi sipas të cilit masa e sigurimit “arrest në burg” mund të çmohet e papërshtatshme *“vetëm nëse ai ose mbrojtësi i tij i paraqesin gjykatës prova pozitive që tregojnë se kjo gjendje rreziku nuk është e pranishme, apo që nuk është e pranishme në atë shkallë e rëndësi që të bëjë të zbatueshme masën e sigurimit arrest në burg”*.

II. Ndryshimet ligjore (2017/2021): saktësimi i arsytimit në nenin 228/3/a dhe përforcimi i kërkesës për vendim të arsyetuar në nenin 244/1 të KPP

Pas vitit 2011, ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale, pavarësisht se nuk kanë sjellë një transformim rrënjësor të strukturës materiale të neneve 228-230, kanë bërë të domosdoshme disa saktësime të rëndësishme metodologjike. Ato e bëjnë më të qartë standardin e arsyetimit që duhet të ndjekë gjykata në kufizimin e lirisë personale.

Së pari: ndryshim me peshë për masat e sigurimit lidhet me nenin 228/3/a të KPP, i cili kërkon që, kur masa justifikohet me rrezikun ndaj provës, ky rrezik të mbështetet **“bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit”**. Kjo shtesë e përjashton arsyetimin abstrakt dhe imponon një arsyetim të verifikueshëm. Rreziku nuk mund të jetë formulë standarde (“rrezik prishjeje provash”), por duhet të argumentohet me elementë konkretë të çështjes. Vetë përdorimi nga ligji i shprehjes “duhet të tregohen posaçërisht” nënvizon se arsyetimi nuk mund të jetë as i nënkuptuar, as i mbështetur në referime të përgjithshme të natyra e akuzës apo të pesha e saj në plan të përgjithshëm, por duhet të individualizohet në raport me situatën konkrete procedurale.

Së dyti: ndryshimet e vitit 2017 kanë përforcuar detyrimin për vendim të arsyetuar në fazën e caktimit të masës. Neni 244/1 i KPP parashikon shprehimisht se vendimi merret në dhomë këshillimi dhe ***“jepet i arsyetuar”***. Ky përforcim nuk ndryshon kriteret materiale të masës, por e vendos edhe më qartë theksin të cilësia e arsyetimit, që do të thotë se vendimmarrja mbi lirinë personale duhet të jetë e arsyetuar në mënyrë të tillë që të jetë e kontrollueshme dhe e verifikueshme, jo e mbështetur në formulime standarde. Edhe ndryshimi i bërë në nenin 245 të KPP me ligjin nr. 35/2017 ka për qëllim forcimin e detyrimit të gjykatës për të arsyetuar vendimin kur cakton një masë sigurimi. Konkretisht, është shtuar kërkesa që në vendim të përfshihet jo vetëm parashtrimi i shkaqeve dhe i të dhënave që justifikojnë masën e sigurimit, por edhe arsyetimi pse gjykata nuk pranon pretendimet e mbrojtjes dhe pse masat e tjera më të lehta të sigurimit konsiderohen të papërshtatshme, veçanërisht kur vendosen masa shtrënguese si ato të parashikuara në nenet 237, 238 dhe 239. Në këtë kuptim, kërkesa për vendim të arsyetuar nuk ka vetëm funksion formal-redaktues, por shërben si garanci substanciale kundër automatizmit në caktimin e paraburgimit dhe si kusht për kontrollin efektiv nga gjykatat më të larta.

Së treti: edhe nëse nenet 229 dhe 230 të KPP nuk kanë pësuar ndryshime thelbësore që të ndryshojnë logjikën e tyre bazë, ato mbeten boshti normativ që kërkon zbatim real dhe të njëtrajtshëm. Neni 229 imponon vendosjen e balancës së përshtatshmërisë/proporcionalitetit të masës me nevojat e sigurimit, ndërsa neni 230 e vendos “arrestin në burg” si masë të fundit, ***“vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme”***.

Në këtë kuptim, këto ndryshime ligjore nuk imponojnë domosdoshmërisht një standard të ri material për masat e sigurimit, por kërkojnë që standardi i arsyetimit gjyqësor të lexohet dhe të zbatohet në mënyrë më të individualizuar, më të kontrollueshme dhe në përputhje me karakterin përjashtimor të kufizimit të lirisë personale.

III. Standardet detyruese të GJEDNJ-së në çështjet Hysa, Gëllçi, Muçaj

Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në interpretim të nenit 5 § 3 të Konventës, ka zhvilluar standarde të qëndrueshme lidhur me kushtet dhe arsyetimin që kërkohet për justifikimin e kufizimit të lirisë personale gjatë procedimit penal. Ajo ka vendosur një standard të qartë: paraburgimi nuk justifikohet me formula stereotipe, por vetëm me arsye “relevante” dhe “të mjaftueshme”, të mbështetura në rrethana konkrete, të individualizuara dhe të kontrollueshme. Në këtë linjë, çështjet Hysa, Gëllçi dhe Muçaj ofrojnë të njëjtin orientim themelor: **(i)** dyshimi i arsyeshëm është kusht i domosdoshëm, por jo i vetmi; **(ii)** rreziku nuk mund të prezumohet në mënyrë abstrakte; dhe **(iii)** vazhdimësia e kufizimit të lirisë kërkon justifikim gjithnjë e më të kujdesshëm në kohë.

Në çështjen *Gëllçi* kundër Shqipërisë, Gjykata përsërit parimin themelor se “vijimësia e një dyshimi të arsyeshëm është kusht sine qua non për vlefshmërinë e arrestit në burg, por nuk mjafton më pasi kalon një fare kohe”. Në këtë rast, gjykata duhet të verifikojë nëse shkaqe të tjera të dhëna nga autoritetet gjyqësore vazhdojnë të justifikojnë heqjen e lirisë. Nëse këto shkaqe janë “relevante” dhe “të mjaftueshme”, gjykata duhet gjithashtu të sigurohet nëse autoritetet kompetente kombëtare kanë treguar “kujdesin e veçantë” në zhvillimin e procesit.” (§ 19).

Në të njëjtën linjë, çështja *Hysa* e përforcon standardin edhe më qartë se “vijimi i një dyshimi të arsyeshëm është kusht sine qua non për vlefshmërinë e paraburgimit, por, pasi ka kaluar një kohë e caktuar, ai nuk është më i mjaftueshëm. Atëherë, Gjykata duhet të vlerësojë: së pari, nëse arsye të tjera të cituara nga autoritetet gjyqësore vijnë të justifikojnë privimin e lirisë; dhe, së dyti, nëse, kur këto arsye janë “të duhurat” dhe “të mjaftueshme”, autoritetet vendëse kanë shfaqur “kujdes të veçantë” në realizimin e procesit. Justifikimi për çfarëdo periudhe burgimi duhet të demonstronhet në mënyrë bindëse nga autoritetet” (§ 63).

Në çështjen *Gëllçi*, Gjykata kritikon arsyetimet e përgjithshme për rrezikun e manipulimit të provave/kërcënimit të dëshmitarëve dhe thekson se “Nuk mund të pranohet parashtrimi i Qeverisë ... në mungesë të provave faktike konkrete mbështetëse ose të ndonjë indicieje për tentativën aktuale ... për t’u përfshirë në manipulimin e provave.” (§ 23). Në të njëjtën çështje, Gjykata vëren se argumente thelbësore të kërkuesit: “nuk janë peshuar siç duhet” (p.sh. kthimi vullnetar, dorëzimi vetë, lidhjet familjare/profesionale)” dhe se “arsyetimi i gjykatave të brendshme nuk u shtjellua për të reflektuar situatën në zhvillim ...” (§ 24).

Në çështjen *Hysa*, Gjykata thekson se “argumentet e gjykatave vendase në favor të dhe kundër lirimit nuk duhet të jenë të përgjithshme dhe abstrakte, por të përmbajnë referenca për fakte specifike dhe rrethana personale që justifikojnë paraburgimin e kërkuesit” (§ 68). Po ashtu, “rëndësia e veprës apo pasojat e saj nuk përbëjnë arsye të pavarura që justifikojnë burgimin” (§ 74).

Në të njëjtën linjë, edhe në çështjen *Muçaj* kundër Shqipërisë, Gjykata vuri në dukje se “gjykatat vendase vijuan t’i referoheshin rrezikut për t’iu fshehur drejtësisë si arsye kryesore për paraburgimin e zgjatur të kërkuesit, pa treguar se si ky rrezik gjente zbatim konkretisht në rastin e tij. Gjykata theksoi gjithashtu se serioziteti i veprës ose pasojat e saj nuk përbëjnë arsye të pavarura që justifikojnë ndalimin me burgim.” (§ 22).

Në çështjen *Hysa*, Gjykata vëren se vendimet vendase “konstatonin se masat alternative ... konsideroheshin të papërshtatshme ... Megjithatë, përveçse një deklaratë formale se masat e

tjera ishin marrë në konsideratë, vendimet vendase nuk i referoheshin në thelb masën e konsideratës që gjykatat vendase kishin treguar ndaj masave alternative ...” (§ 76). Në çështjen Gëllçi, Gjykata thekson në mënyrë të ngjashme se “nuk duket as që ato gjykata kanë vlerësuar siç duhet ndonjë masë sigurimi alternative përtej një deklarate thjesht formale” (§ 25). I njëjti përfundim del edhe nga çështja Muçaj kundër Shqipërisë, ku Gjykata konstatoi se gjykatat vendase nuk kishin marrë në konsideratë ndonjë masë alternative sigurie përtej një deklarimi formal.

Në çështjen Hysa, Gjykata e formulon në mënyrë eksplicite se “*Justifikimi për çfarëdo periudhe burgimi ... duhet të demonstrohet në mënyrë bindëse nga autoritetet.*” (§ 63). Në të njëjtin drejtim, edhe çështja Muçaj tregon se kontrolli sipas nenit 5 § 3 të Konventës nuk lidhet vetëm me momentin fillestar të vendosjes së paraburgimit, por edhe me vazhdimësinë e justifikimit të tij në kohë. Edhe kur shqyrtimi fokusohet te kohëzgjatja e masës, standardi mbetet i njëjtë: autoritetet nuk mund të mbështeten në inercinë e vendimit fillestar, por duhet të demonstrojnë, me arsye aktuale dhe të kontrollueshme, se kufizimi i lirisë vijon të jetë i domosdoshëm.

Në përmbledhje, jurisprudenca e GJEDNJ-së në çështjet Hysa, Gëllçi dhe Muçaj imponon këto teza themelore: (i) dyshimi i arsyeshëm nuk mjafton, i vetëm, për vijimin e paraburgimit; (ii) rreziku duhet të jetë konkret, i individualizuar dhe i provueshëm; (iii) rëndësia abstrakte e veprës nuk justifikon, më vete, burgimin; (iv) masat alternative duhet të shqyrtohen realisht dhe jo formalisht; (v) barra e justifikimit mbetet mbi autoritetet për çdo periudhë kufizimi të lirisë; dhe (vi) justifikimi i paraburgimit duhet të ruajë aktualitet, proporcionalitet dhe kontrollueshmëri në kohë.

Në këtë drejtim, duhen mbajtur në konsideratë:

- ndryshimet ligjore të ndërmarra në Kodin e Procedurës Penale pas vitit 2011;
- kërkesa për një arsyetim të individualizuar, të kontrollueshëm dhe të mbështetur në rrethana konkrete të faktit në vendimmarrjen mbi masat e sigurimit;
- standardet e zhvilluara nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në interpretim të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, veçanërisht në lidhje me ndalimin e arsyetimit stereotip, nevojën për arsye relevante dhe të mjaftueshme, si dhe shqyrtimin real të alternativave ndaj paraburgimit.

Në këto kushte, vlerësohet se ekzistojnë arsye të mjaftueshme institucionale dhe juridike për nisjen e procedurës sipas nenit 438 të Kodit të Procedurës Penale, me qëllim që Kolegjet e Bashkuara të vlerësojnë:

- nëse disa prej formulimeve të vendimit unifikues nr. 7/2011 kërkojnë ndryshim të pjesshëm; si dhe
- nëse paraqitet nevoja për njësimin ose zhvillimin e mëtejshëm të praktikës gjyqësore në këtë fushë.

IV. Kuadri procedural dhe roli i Kolegjeve të Bashkuara

Neni 438 i Kodit të Procedurës Penale parashikon shprehimisht se nisja e procedurës për ndryshimin e praktikës gjyqësore të njësuar mund të vendoset edhe nga Kryetari i Gjykatës së Lartë. Kjo kompetencë synon të garantojë që praktika unifikuese e Gjykatës së Lartë të mbetet e përditësuar, koherente dhe e aftë të korrigjojë keqkuptimet ose devijimet që mund të krijohen në zbatim, qoftë si pasojë e vjetërsisë të tezave unifikuese, qoftë nga saktësimet ligjore, qoftë nga evoluimi i standardeve detyruese kushtetuese e konventore.

Në rrethanat aktuale, nisma për ndryshimin e pjesshëm të vendimit unifikues nr. 7, datë 14.10.2011, justifikohet nga nevoja për të rikthyer parashikueshmërinë, kontrollueshmërinë dhe njëtrajtshmërinë e vendimmarrjes mbi masat e sigurimit personal në një fushë ku vendimi prek drejtpërdrejt lirinë personale. Praktika gjyqësore duhet të reflektojë në mënyrë të qëndrueshme testin ligjor të domosdoshmërisë, proporcionalitetit dhe karakterit përjashtimor të “arrestit në burg”, si dhe standardin konventor të nenit 5 të KEDNJ-së, që kërkon arsyetim të individualizuar, shmangie të formulave stereotipe dhe shqyrtim real të alternativave.

Objekti i kësaj nisme mbetet ndryshimi i pjesshëm i praktikës unifikuese të vitit 2011, pa përjashtuar kompetencën e Kolegjeve të Bashkuara që, gjatë shqyrtimit, të vlerësojnë edhe nevojën për njësim ose zhvillim të mëtejshëm të praktikës gjyqësore, në masën që kjo del e domosdoshme nga ndryshimet e legjislacionit procedural penal dhe nga risitë që ka sjellë jurisprudenca e GJEDNJ.

Kuadri procedural i nenit 438 KPP, në formulimin e tij aktual, e bën këtë ndërhyrje më të qartë, më transparente dhe më gjithëpërfshirëse. Ai parashikon nxjerrjen e një vendimi të ndërmjetëm, evidentimin e çështjes konkrete që ka nxitur nismën, paraqitjen e arsyeve që justifikojnë rivënien në diskutim të praktikës së mëparshme të njësuar, si dhe përcaktimin e çështjeve që i shtrohen për shqyrtim Kolegjeve të Bashkuara. Vlerësimi përfundimtar mbi themelin e çështjeve të shtruara, mbi përmbajtjen e standardit që duhet të ndiqet, si dhe mbi shtrirjen e mundshme të ndryshimit, njësimit ose zhvillimit të praktikës gjyqësore, i përket Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Përcaktimi i çështjeve të mësipërme për shqyrtim nuk nënkupton parapërcaktim të zgjidhjes së tyre në themel dhe as qëndrim përfundimtar mbi mënyrën e interpretimit të dispozitave ligjore përkatëse. Ky vendim i ndërmjetëm ka vetëm funksionin procedural të vënies në lëvizje të mekanizmit të parashikuar nga neni 438 i Kodit të Procedurës Penale dhe të përcaktimit të objektit të shqyrtimit përpara Kolegjeve të Bashkuara, të cilave u takon vlerësimi përfundimtar mbi themelin, shtrirjen dhe përmbajtjen e mundshme të ndryshimit, njësimit ose zhvillimit të praktikës gjyqësore.

V. Çështjet që shtrohen për shqyrtim përpara Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

Në funksion të objektit të këtij vendimi të ndërmjetëm që lidhet me ushtrimin nga Kryetari i Gjykatës së Lartë të nismës për ndryshimin e pjesshëm të praktikës së njësuar, dhe me qëllim që

shqyrtimi përpara Kolegjeve të Bashkuara të jetë i qartë dhe metodologjikisht i rregullt, shtrohen për zgjidhje këto çështje:

1. Në interpretim të neneve 228 dhe 230 të KPP, a është në përputhje me këto dispozita dhe me nenin 5 § 3 të KEDNJ qëndrimi sipas të cilit, kur kërkohet ose vendoset masa e “arrestit në burg”, gjykata nuk ka detyrim të analizojë realisht masat alternative dhe mjafton të arsyetojë se masa e zgjedhur prej saj është e përshtatshme për rastin konkret?

2. Në interpretim të neneve 228 dhe 230 të KPP, a mund të nxirret “rrezikshmëria e veçantë e veprës dhe e të pandehurit”, si kriter për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” vetëm ose kryesisht nga natyra e veprës penale, nga rëndësia e saj e përgjithshme ose nga marzhi i dënimit, pa një vlerësim konkret dhe të individualizuar të rrethanave të rastit dhe të personit?

3. Kujt i takon barra e justifikimit të nevojës për caktimin dhe vijimin e masës së “arrestit në burg” dhe a është në përputhje me nenin 5 § 3 të KEDNJ dhe me nenet 228-230 të KPP qëndrimi sipas të cilit papërshtatshmëria e kësaj mase mund të pranohet vetëm nëse i pandehuri paraqet prova pozitive?

Këto çështje përcaktojnë objektin e shqyrtimit përpara Kolegjeve të Bashkuara dhe synojnë të mundësojnë një vlerësim të plotë, të njëtrajtshëm dhe të përditësuar të standardit të zbatimit të neneve 228-230 të Kodit të Procedurës Penale, në përputhje me kuadrin aktual ligjor dhe konventor.

Shqyrtimi i tyre nga Kolegjet e Bashkuara synon të qartësojë standardin e zbatimit të dispozitave përkatëse pa paragjykuar përfundimin që do të arrihet në themel të çështjeve të shtruara.

Përfundimisht, në kushtet kur çështja konkrete ngre probleme që prekin drejtpërdrejt praktikën e mëparshme të njësuar të Kolegjeve të Bashkuara, si dhe në kushtet kur pas vitit 2011 janë zhvilluar elemente të rëndësishme në plan ligjor dhe jurisprudencial, çmohet se janë përmbushur kushtet për nisjen e procedurës për ndryshimin e pjesshëm të praktikës gjyqësore të njësuar, sipas nenit 438 të Kodit të Procedurës Penale.

Kjo nismë ka për qëllim garantimin e një praktike gjyqësore të njëtrajtshme, të kontrollueshme dhe në përputhje me standardet kushtetuese, ligjore dhe konventore që rregullojnë kufizimin e lirisë personale. Në këtë mënyrë synohet që praktika gjyqësore të mbetet në përputhje të plotë me kuadrin aktual ligjor dhe me standardet kushtetuese e konventore që rregullojnë kufizimin e lirisë personale.

PËR KËTO ARSYE

Kryetari i Gjykatës së Lartë, në mbështetje të nenit 438 të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI:

1. Nisjen e procedurës për ndryshimin e pjesshëm të praktikës gjyqësore të njësuar, lidhur me vendimin nr. 7, datë 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

2. Kalimin e çështjes në seancë gjyqësore përpara Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për shqyrtimin e ndryshimit të pjesshëm të praktikës gjyqësore të njësuar dhe, sipas rastit, të njësimit ose zhvillimit të mëtejshëm të praktikës gjyqësore, lidhur me këto çështje:

2.1. Në interpretim të neneve 228 dhe 230 të KPP, a është në përputhje me këto dispozita dhe me nenin 5 § 3 të KEDNJ qëndrimi sipas të cilit, kur kërkohet ose vendoset masa e “arrestit në burg”, gjykata nuk ka detyrim të analizojë realisht masat alternative dhe mjafton të arsyetojë se masa e zgjedhur prej saj është e përshtatshme për rastin konkret?

2.2. Në interpretim të neneve 228 dhe 230 të KPP, a mund të nxirret “rrezikshmëria e veçantë e veprës dhe e të pandehurit” si kriter për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, vetëm ose kryesisht nga natyra e veprës penale, nga rëndësia e saj e përgjithshme ose nga marzhi i dënimit, pa një vlerësim konkret dhe të individualizuar të rrethanave të rastit dhe të personit?

2.3. Kujt i takon barra e justifikimit të nevojës për caktimin dhe vijimin e masës së “arrestit në burg” dhe a është në përputhje me nenin 5 § 3 të KEDNJ dhe me nenet 228-230 të KPP qëndrimi sipas të cilit papërshtatshmëria e kësaj mase mund të pranohet vetëm nëse i pandehuri paraqet prova pozitive?

3. Caktimin e datës 9/04/2026, ora 9.30, për zhvillimin e seancës gjyqësore përpara Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

4. Publikimin e këtij vendimi të ndërmjetëm në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

5. Njoftimin e palëve nga sekretaria gjyqësore, sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit, të paktën 15 ditë përpara datës së zhvillimit të seancës gjyqësore.

Tiranë, më 09.03.2026

KRYETARI

SOKOL SADUSHI